



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

---

# Buletini informativ

- \* Aktivitetet e përgjithshme
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- \* Aktivitetet nga trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor si dhe stafin tjetër administrative të gjykatave dhe prokurorive

Tetor 2023

## Aktivitetet e përgjithshme

### Trajnim i stafit të AD-së mbi menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve përmes e-prokurimit

Me datë 12 tetor 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik në Kosovë kanë realizuar trajnimin me temë: “Menaxhimi i kontratës dhe vlerësimi i performancës së kontraktorëve përmes sistemit të e-prokurimit”.

Ky trajnim i është dedikuar stafit të Akademisë së Drejtësisë, Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe u ofrua nga z. Osman Bytyçi, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim në KRPP dhe trajner në fushën e prokurimit publik

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja me platformën e sistemit të e-prokurimit e cila i'u lehtëson menaxherëve të kontratave nga institucionet publike menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve.

Trajnimi në fillim u përqendrua në shpjegimet e nevojshme sa i përket monitorimit të kontratave, krijimit të dokumentit të planit të menaxhimit të kontratës, planit të azhurnuar, menaxhimit të ekzekutimit të kontratave, faturave duke përfshirë edhe specifikat tjera si përmbyllja e

kontratës, ndërprerja, porositë sipas kontratave të centralizuara dhe menaxhimi i mini tenderëve.

Në vijim u trajtuan edhe vlerësimi i performancës së kontraktorëve, procesi i vlerësimit të një kontrate, modifikimi i vlerësimit të një kontrate, aprovimi si dhe monitorimi i performancës së kontraktorëve.

Në pjesën e pasdites u demonstrua platforma dhe funksionaliteti i saj përmes moduleve të dizajnuara për menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve përmes sistemit të e-prokurimit. Gjatë këtij trajnimi gjithashtu u diskutuan edhe çështjet ligjore dhe praktikat më të mira sa i përket menaxhimit të kontratave në prokurimin publik.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin rreth 30 zyrtarë të prokurimit, zyrtarë përgjegjës dhe të ngarkuar për menaxhim të kontratave të këtyre tri (3) Autoriteteve Kontraktuese, të cilët në fund të trajnimit u pajisën me certifikata të pjesëmarrjes.



## Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

### Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e X)- 2023-2024

---



Gjatë muajit tetor për 21 prokurorët e kësaj gjenerate janë realizuar gjithsej 22 sesione të trajnimit teorik dhe 11 ditë të trajnimit praktik. Sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli: Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe nga moduli: Kodi i Procedurës Penale.

Në kuadër të modulit: Kodi Penal i Republikës së Kosovës është realizuar 1 sesion trajnues për “Përgjegjësinë e personave juridik” me theks te bazat dhe kufiri i personave juridik.

Në kuadër të modulit: Kodi i Procedurës Penale janë realizuar 2 sesione nga nën moduli: “Fillimi i hetimeve formale dhe procedura penale” me ç ‘rast janë trajtuar rifillimi dhe pushimi i hetimeve, zgjerimi dhe pezullimi i hetimeve.

Nga nën moduli: “Kallëzimi penal” janë realizuar 2 sesione për hedhjen e kallëzimit penal, dhe kallëzimi penal nga burimet tjera.

Nga nën moduli: “Kontrolli dhe konfiskimi” janë realizuar 4 sesione prej të cilëve janë shtjelluar: Dispozitat e KPP lidhur me konfiskimin dhe sekuestrimin, dispozitat e KPRK, Ligji mbi kompetencat e zgjeruara të

konfiskimit, objekt studimi - Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në kuadër të nën modulit: “Masat e fshehta të hetimit dhe të vëzhgimit” janë realizuar 6 sesione nga ku janë trajtuar: Ekipet, njësitet e përbashkëta hetimore, parimet dhe standardet ndërkombëtare për zbatim të masave, përkufizimet e masave të veçanta hetimore, personat kompetent për të urdhëruar dhe zbatuar masat veçanta hetimore, pranueshmëria e provave të siguruara me anë të urdhrit për masat e veçanta hetimore si dhe Zgjatja e urdhrit për masat e veçanta hetimore.

Në vijim të modulit të Kodit të Procedurës penale janë realizuar edhe 3 sesione për “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë” me ç ‘rast janë trajtuar aspekte me rëndësi sa i përket arrestit shtëpiak, diversioni dhe paraburgimi .

Nga nën moduli për Vendin e ngjarjes dhe forenzikën janë realizuar 4 sesione trajnuese me theks te: forenzika, sigurimi i vendit të ngjarjes dhe fazat e kryerjes së këqyrjes, simulimi, vendi i ngjarjes, kuptimi dhe hapat e parë që duhet ndërmarrë.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.

## Trajnimi për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e X)-2023-2024

Gjatë muajit tetor, për gjyqtarët e kësaj gjenerate gjithsej (28 gjyqtarë, prej tyre një nga komuniteti boshnjak dhe një nga ai turk) janë realizuar gjithsej 38 sesione të trajnimit teorik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga nën modulet e modulit: Kodi Penal të Republikës, Kodit Penal të Kosovës si dhe nga moduli: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese .

Nga moduli: “Kodi Penal i Republikës së Kosovës” janë realizuar 4 sesione trajnuese me theks te Udhëzuesi për politikën ndëshkimore me ç ‘rast janë trajtuar rrethanat për ashpërsimin e dënimit, rrethanat për zbutjen e dënimit, udhëzuesi i përgjithshëm i politikës ndëshkimore si dhe udhëzuesi specifik për caktimin e dënimit me gjobë.

Nga moduli Kodi i Procedurës Penale janë realizuar 3 sesione trajnuese për aktgjykimet dhe lloje e tij përkatësisht për aspekte të rëndësishme të aktgjykimit lirues dhe refuzues, aktgjykimit dënues dhe vendimet gjyqësore në procedurën penale.

Në vijim të këtij moduli janë realizuar edhe 5 sesione trajnuese për “Procedurat alternative” me ç ‘rast janë trajtuar, kushtet kur ndjekja nuk është e detyrueshme (Neni 228), lirimi nga dënimi, negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë (Neni 230), pezullimi i përkohshëm i procedurës (neni 227).

Nga nën moduli: “Procedura penale e kryesve me çrregullime mendore” janë realizuar 4 sesione nga i cili janë shtjelluar: ekzaminimi psikiatrik i kryerësve me çrregullime mendore, paraburgimi për kryerësit me çrregullime mendore, përgjegjësia penale e personit fizike, shqiptimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Nga nën moduli: “Procedurat e veçanta sipas KPPK” janë realizuar 3 sesione nga të cilët gjyqtarët kanë përfituar njohuri rreth caktimit të

paraburgimit ndaj të miturit me çrregullime mendore, paraburgimi, procedurat ndaj personave të cilët kanë kryer vepra penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës dhe procedurat penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime.

Në kuadër të nën modulit: “Prokurori i shtetit, mbrojtësi, i dëmtuari dhe i pandehuri si palë në procedurën penale” janë trajtuar po ashtu 3 sesione: i dëmtuari në procedurën penale, i pandehuri dhe mbrojtësi në procedurën penale si dhe prokurori i shtetit.

Nga nën moduli: “Provat në procedurën penale” janë realizuar 4 sesione trajnuese me ç ‘rast janë trajtuar Ekspertimi dhe masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit dhe llojet e tyre si prova, kontrolli, këqyrja kërkesat ndërkombëtare, provueshmëria dhe pranueshmëria, kuptimi dhe llojet e provave në procedurën penale, burimi i provës dhe mjeteve provuese, provat sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Në kuadër të nën modulit: “Shqyrtimi fillestar dhe i dytë” është realizuar 1 sesion nga i cili është trajtuar: Kundërshtimi i provave, kërkesa për hedhjen e aktakuzës dhe shqyrtimi i dytë si dhe nga nën moduli: “Shqyrtimi gjyqësor” janë realizuar 5 sesione trajnuese, me theks te: fjala përfundimtare, si dhe procedura e marrjes dhe e shpalljes së aktgjykimit, paraqitja e provave, rrjedha e shqyrtimit gjyqësor, shtyrja, ndërprerja dhe koha e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, si dhe porcesverbali i shqyrtimit gjyqësor, zbatimi i shqyrtimit gjyqësor dhe parakushtet për mbajtën e shqyrtimit gjyqësor.

Nga moduli “Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese” janë realizuar 2 sesione trajnuese, në kuadër të cilave është trajtuar Ligji për kundërvajtje me theks te organet për paraqitje të kërkesës për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes, aktgjykimet-aktvendimet dhe mjetet juridike, veprat e kundërvajtjes, procedura e kundërvajtjes dhe aktgjykimi mbi kundërvajtje.

Po ashtu është realizuar nën moduli: Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore dhe Simulimi” 4 sesione nga i cili gjyqtarët kanë avancuar teknikat gjyqësore rreth marrjes në pyetje, fjalës hyrëse, përfundimtare dhe vënia në dyshim.

Po ashtu gjatë muajit tetor gjyqtarët e sapo emëruar në kuadër të Programit për vizita në institucionet jo gjyqësore kanë realizuar vizitë në: Agjencinë për informim dhe privatësi.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik gjyqtarët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.

Gjatë muajit tetor 2023, një gjyqtar ka realizuar trajnim praktik në gjykatë nga lëmia civile



## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### Trajnim: Kripto Asetet dhe përdorimi i tyre për veprën e Pastrimit të Parave

Më 03-04 Tetor 2023, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës - PECK III, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Kripto Asetet dhe përdorimi i tyre për veprën e Pastrimit të Parave”

Trajnimi u realizua nga ekspert të Këshillit të Evropës z. Richard Strike dhe z. Andrew Tennant

Qëllimi i këtij trajnimi ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira të jurisprudencës Evropiane sa i përket rasteve që kanë të bëjnë me Kripto asetet dhe përdorimit të tyre për veprën e pastrimit të parave për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve përkatëse.

Trajnimi në fillim u përqendrua në shpjegime të hollësishme sa i përket monedhave virtuale të cilat së fundmi po bëhen realitet i ri jo vetëm për sistemet financiare, botën digjitale dhe përdoruesit e tyre, por edhe për organet e zbatimit të ligjit dhe gjyqësinë. Pavarësisht ekzistencës dhe qëllimit të tyre legjitim,

monedhat virtuale shpesh janë në shënjestër të kriminelëve dhe paraqiten si mjete të përdorura për kryerjen e veprës ose që janë si rrjedhojë e një veprë penale ose si pasuri e përfituar nga kryerja e veprave penale, gjë që kushtëzon nevojën që organet e ndjekjes të njohin konceptin e monedhave virtuale, përdorimin e tyre dhe për rrjedhojë, keqpërdorimin e tyre për qëllime kriminale.

Në ditën e dytë trajnimi filloj me një rast praktik duke punuar në grupe ku trajnuesi parashtrij pyetje për pjesëmarrësit të cilët më pas ndanë përvojat e tyre në lidhje me situata të caktuara..

Këtë trajnim e vijuan 34 pjesëmarrës. Prej tyre 10 gjyqtarë, 7 prokurorë, 2 ekspert nga PRSK, 2 zyrtarë të lartë nga Banka Qendrore, 2 analistë dhe 1 inspektorë hetues nga Administrata Tatimore, 3 analistë nga Njësia e Inteligjencës Financiare, 5 hetues nga Policia e Kosovës, 1 hetues nga Dogana e Kosovës si dhe 1 zyrtarë i lartë nga Agjencia për Parandalim të Korrupsionit.



## Kontrata për ndërtimin

Më 03 tetor 2023, në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “Kontrata për Ndërtimin”.

Ky trajnim vjen si rezultat i kurrikulës bazë trajnuese për gjyqtarët e Gjykatës Komerciale, e ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe njohurive për kontratat për ndërtimin për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve në praktikën gjyqësore.

Për dy ditë me radhë, pjesëmarrësit patën rastin të dëgjojnë dhe diskutojnë rreth Kontratës për ndërtimin dhe efektet juridike të saj. Për Kontratat Publike të Ndërtimit, Aktet nënligjore dhe aktet e tjera nga fusha e ndërtimtarisë që janë të aplikueshme në gjykimin e kontesteve të kësaj natyre, shuarjen e Kontratës për ndërtimin

dhe përgjegjësinë për të metat në punime, si dhe praktikën gjyqësore që rrjedh nga kontestet nga kontrata për ndërtim.

Pjesë e trajnimit ishin edhe rastet praktike, ushtrime mes trajnuesit dhe pjesëmarrësve në shqyrtimin e rasteve konkrete dhe hipotetike nga natyra e kontesteve prej kontratës së ndërtimit.

Këtë trajnim e vijuan 28 gjyqtarë. Prej tyre 10 gjyqtarë nga Gjykata Komerciale si dhe 18 të tjerë nga gjykatat tjera, përkatësisht divizioni civil me ç ‘rast 1 ishte nga Apeli, 2 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe tjerët nga niveli i gjykatave themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.



## Trajnim: Hetimi i trafikimit të fëmijëve me fokus te fëmijët në situatë rruge



Më 04-06 Tetor 2023, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës - Projekti Forcimi i veprimeve anti-trafikim, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi për prokurorë dhe hetues të Policisë së Kosovës, përkatësisht nga Drejtorja për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore.

Trajnimi u ofrua nga ekspertë të jashtëm, përkatësisht nga z. Sando Kitanov, Këshilltar i lartë për çështje të krimit të organizuar - Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe z. Romulus Ungureanu, Këshilltar ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit të cilët kanë komentuar raste nga praktika rreth hetimeve dhe masave parandaluese kundër trafikimit të fëmijëve, veçanërisht mes fëmijëve në situatë rruge të përfshirë në lypje.

Trajnimi u përqendrua në elaborimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore si model biznesi, si dhe në luftimin e suksesshëm të tij me anë të zbatimit të masave proaktive,

Gjatë trajnimi vëmendje e veçantë i është kushtuar trendëve të reja të trafikimit të fëmijëve në nivel evropian, zhvillimeve më të fundit në shkallë globale, digjitalizimit të trafikimit dhe ndërlidhjet me mjedise të ndryshme. Përveq tyre u diskutua edhe për sfidat e hetimeve në internet, shfrytëzimi i mediave sociale në hetime, komunikimi dhe bashkërendimi, bashkëpunimi ndërinstitucional dhe rëndësia e komunikimit, profili psikologjik dhe nevojat e veçanta të viktimave të trafikimit, trauma që prek viktimat e trafikimit, dinamika

kulturore (feja, zhvatja, frikësimi) si dhe për ndikimin e trafikimit ndërkombëtar dhe veprimtarisë kriminale ndërkufitare.

Me rastin e këtij trajnimi u potencua se shtetet anëtare duhet të forcojnë dhe ti japin përparësi zbulimit të rasteve të trafikimit me qenie njerëzore për shfrytëzim për punë dhe identifikimit të viktimave. Për këtë qëllim duhet të krijohen mekanizma efektivë për raportim të sigurt, mundësi konkrete për rregullimin e statusit të vendbanimit të viktimave të trafikimit dhe qasje në tregun e punës. Shtuar kësaj edhe mundësinë reale të tyre për kompensim dhe pagesa për periudhën e mëparshme. Përveç kësaj u tha se shtetet duhet të përcaktojnë parametrat e shfrytëzimit për punë qoftë me ligj ose me anë të udhëzimeve dhe të krijojnë procedura specifike hetimore dhe njësi të specializuara në kuadër të policisë dhe Zyrës së Prokurorit.

Trajnimi u ofroi pjesëmarrësve studime të rasteve dhe skenarë mbi tendencat aktuale dhe grupeve të krimit të organizuar që merren me trafikimin e fëmijëve dhe qasje praktike proaktive hetimore nëpërmjet aplikimit të masave të veçanta hetimore nga agjencitë ligj zbatuese dhe prokuroria.

Të gjithë të pranishmit e përfunduan debatin me një përshtypje të përgjithshme se trajnimi ishte produktiv dhe i dobishëm, pasi të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në bisedë. Në fund ekspertët falënderuan pjesëmarrësit për angazhim konstruktiv që patën gjatë këtyre tre ditëve, si dhe falënderuan Akademinë e Drejtësisë për realizimin e këtij trajnimi dhe bashkëpunimin e ndërsjellët që ka me Këshillin e Evropës dhe OSBE.

Këtë trajnim e vijuan 26 pjesëmarrës. Prej tyre 11 prokurorë 15 hetues nga Policia e Kosovës.



## Trajnim: Ndërmjetësimi-regjioni (Prishtinë-Mitrovicë)

Më 05 tetor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me Programin e “USAID – Drejtësia Komerciale”, është realizuar trajnimi me temë “Ndërmjetësimi” për regjionin e Prishtinës dhe Mitrovicës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe ndërmjetësuesve lidhur me metodën alternative për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet dy apo më shumë personave dhe zbatimin e drejtë të ndërmjetësimit dhe procedurës në praktikë.

Trajnimi ka filluar direkt me shtjellimin nga ana e trajnuesit për gjendjen aktuale të ndërmjetësimit dhe shkaktarët që e kanë sjell në këtë gjendje ku janë renditur në tri grupe: keqkuptimi, keqinterpretimi dhe keqpërdorimi, duke vazhduar me dhënien e sqarimeve për secilin grup.

Në trajnim fokus i veçantë ka qenë roli i gjyqtarit dhe ndërmjetësuesit në procedurën e ndërmjetësimit, pasi që në praktikë nuk është duke u vepruar konform rolit dhe përgjegjësisë nga këta dy akterë kryesor.

Po ashtu është diskutua edhe referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore. Vëmendje të veçantë iu kushtua zbatimit të procedurës tek ndërmjetësimi i detyrueshëm, ekzaminimit të marrëveshjes së ndërmjetësimit dhe hapat që pasojnë duke përfshirë edhe debat profesional, shoqëruar me praktike, dhe me udhëzime të qarta dhe bindëse pothuajse për secilin problem, sfidë apo dilemë të ngritur.

Ky trajnim shërbeu si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Këtë trajnim e vijuan 35 pjesëmarrës, prej tyre 23 gjyqtarë, 2 prokurorë, 9 ndërmjetësues dhe 1 praktikantë.



## Program i Specializuar i Trajnimit Pastrimi i parave dhe hetimi financiar – Sesioni III

Më 10-11 Tetor 2023, në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtarë (IRZ), në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Pastrimi i parave dhe hetimi financiar-sesioni III”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira të jurisprudencës Kosovare dhe asaj Gjermane sa i përket rasteve të veprave penale të pastrimit të parave për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve përkatëse.

Gjatë këtij trajnimi u diskutua për figurën e krimit të pastrimit të parave sipas të drejtës kosovare, rreziqet më të larta dhe format më të shpeshta të shfaqjes e cila u elaborua nga gjyqtari i Apelit në Prishtinë, Burim Ademi e më pastaj edhe nga perspektiva gjermane nga Gerhard Karl Brinker, Prokuror Kryesues, Prokuroria e Hamburgut, njëherësh Drejtues i Seksionit për Rikuperimin Pasuror dhe Luftën kundër Pastrimit të Parave si dhe Donika Mehmeti, Gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Hamburgut.

Për dy ditë me radhë nga dy perspektivat u trajtuan edhe sekuestrimi dhe rikuperimi i të

ardhurave nga veprat penale, aspekte të rëndësishme të hetimeve të thelluara financiare për rrëzimin e deklarimeve të mundshme, për përdorimin e formave të ndërmarrjeve me synim legjitimimin e pastrimit të parave, raporti ndërmjet veprës penale fillestare dhe pastrimit të parave, për mundësitë e sanksionimit sipas të drejtës penale në kontekstin e pastrimit të parave dhe efektet mbi të tretët, për ndihmën e ndërsjellë dhe bashkëpunimin ndërkombëtarë në hetimet në hetimet në lidhje me pastrimin e parave si dhe për rolin e Njësisë së Inteligjencës Financiare në kuadrin e luftës kundër pastrimit të parave dhe zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit të rasteve praktike për të gjitha çështjet që trajtuan në këto dy ditë për të cilat ofruan zgjidhjet e tyre ligjore.

Këtë trajnim e vijuan 30 pjesëmarrës. Prej tyre 13 gjyqtarë, 14 prokurorë si dhe 3 hetues nga Policia e Kosovës.



## Trajnim: Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështje civile- E drejta familjare me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar



Më 12-13 tetor 2023, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “E drejta familjare me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar” në kuadër të PTV-së me përkrahjen e GIZ-it. Qëllimi i këtij trajnimi dyditor ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në lëmin e së drejtës familjare me element të huaj.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan temat e: Hyrje mbi Ligjin për të Drejtën Ndërkombëtare Private; Hyrje në Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile; dhe Çështjet e divorcit, mbajtjes dhe regjimit pasuror martesor me element të huaj. Ndërsa në ditën e dytë janë trajtuar temat e: Çështjet e divorcit, mbajtjes dhe regjimit pasuror martesor me element të huaj; Trashëgimia me element të huaj; dhe çështje tjera statusore me element të huaj.

Që në fillim të trajnimit u potencua se bashkëpunimi juridik-ndërkombëtar në lëmin civile është më rëndësi sepse në këtë proces mundësohet njohja, hyrja në fuqi e vendimeve

në çështjet civile në mes shteteve andaj këto tema kanë nevojë për një trajtim të gjithanshëm. Posaçërisht u veçua roli i dispozitave të legjislacionit evropian në çështjet civile dhe tregtare.

Në vazhdim u prezantua korniza ligjore vendore për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile dhe Rregulloret e UE-së në këto çështjet. Pastaj u shpjegua gjithanshëm vendbanimi si fakt për caktimin e kompetencës gjyqësore, për të gjithë personat pa marrë parasysh nacionalitetin e tyre. Pastaj çështja tjetër që lidhet me personat që nuk janë shtetas të shtetit anëtar, a vlejné rregullat e juridiksionit të zbatueshëm ndaj shtetasve të atij shteti.

Gjithashtu u trajtua çështja se personi me vendbanim në shtetin anëtar a mund të paditet në një shtet tjetër anëtar. A mund të merren vesh palët për juridiksionin e gjykatës e cila do të merret me kontestet që janë ngritur apo do të ngritën dhe Konventat e Hagës për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Gjithashtu u potencua se bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në lëmin civile, përfshin çështjet që kanë të bëjnë me njohjen dhe përmbartimin e vendimeve të huaja gjyqësore apo vendimeve ekuivalente me këto, kërkesat që burojnë nga Republika e Kosovës, apo nga shtetet e huaja për Kosovën, rolin e gjykatës dhe departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në këtë procedurë, juridiksionin në bazë të legjislacionit në fuqi dhe konventat ndërkombëtare që rregullojnë çështjen e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile, siç janë: Konventa e Luganos, Konventa e Hagës, si dhe disa prej konventave më të rëndësishme që rregullojnë çështjen e cekur më lartë.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime

teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik duke mundësuar aktivizim të pjesëmarrësve. Gjithashtu u përdorën dhe u shtruan skenarë të rasteve që përfshinë disa çështje praktike të bashkëpunimit ndërkombëtar që gjyqtarët po i hasin në punën e tyre të përditshme.

Këtë trajnim e vijuan 42 gjyqtarë ( 4 nga Dhoma e Posaqme e Gjykatës Supreme, 2 nga Gjykata e Apelit dhe 36 të tjerë nga niveli themelor i gjykatave nga të gjitha regjionet) si dhe , dhe 2 zyrtarë ligjor dhe 1 praktikantë nga Ministria e Drejtësisë-Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.

## Trajnim: Risitë e Kodit të Procedurës Penale

Me 13-14 tetor 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me US-DOJ/OPDAT - OSBE, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Risitë e Kodit të Procedurës Penale” për regjionin e Gjilanit.

Qëllimi i trajnimit ishte që pjesëmarrësit të njoftohen me risitë esenciale të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë tendencë për ndryshime të nevojshme dhe efektive dhe zbatimin e drejtë të tyre në praktikë.

Trajnimi u orientua në ndryshimet sa masave të veçanta hetimore, hedhjes së kallëzimit penal që reflekton në mundësinë e ankesës ndaj hedhjes së kallëzimeve penale nga Prokurori Shtetit, pasi që më parë nuk lejohej ankesë ndaj hedhjes së kallëzimit qoftë nga ana e parashtruesit apo të dëmtuarit nga vepra penale. Në vijim të risive ligjore u fol edhe për Mbrojtësin e detyruar, mbrojtësin me shpenzime publike dhe kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, të drejtën për të apeluar aktvendimin, masat e veçanta hetimore, mbrojtja e dëshmitarëve, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake, mundësia hetuese e veçantë, hetimi (afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve).

Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatave dhe prokurorive.

Në këtë trajnim u trajtua edhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit. Ndër të tjera u shtjellua edhe Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor duke u vazhduar me standardin e rishikimit të ankesave shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, gjykimi në mungesë, sekuestrimi dhe konfiskimi si dhe marrja në pyetje në procedure paraprake dhe deklarata në procedure paraprake.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike.

Pjesëmarrës të këtij trajnimi ishin gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional nga regjioni i Gjilanit. Këtë trajnim e vijuan 22 pjesëmarrës. Prej tyre 8 gjyqtarë, 8 prokurorë si dhe 6 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorisë.



## Trajnim: KEDNJ-së si dhe korniza ligjore nacionale në rastet e diskriminimit dhe raporti me ligjet e tjera me theks në Ligjin e Punës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore



Më 17-18 Tetor 2023, në bashkëpunim me OSBE në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “KEDNJ-së si dhe korniza ligjore nacionale në rastet e diskriminimit dhe raporti me ligjet e tjera me theks në Ligjin e Punës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore”.

Gjatë këtij trajnimi për dy ditë me radhë u trajtuan konceptet themelore të Nenit 14 dhe Protokollit 12 të KEDNJ-së, Praktika e GJEDNJ-së lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi, Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin, Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi dhe bashkëveprimi me Ligjin e Procedurës kontestimore dhe Ligjin e punës, Komplexitetet praktike në situatat ku ndërveprojnë ligjet në rastet e diskriminimit, Analizimi i trajtimit të rasteve të diskriminimit në procedurën kontestimore, përfshirë këtu në trajtimin e kontesteve të punës me elemente diskriminimi.

Gjatë trajnimit u diskutua për dokumentet juridike të së drejtës Evropiane dhe detyrimin e

organeve shtetërore për zbatimin e tyre, në përputhje me ligjin e punës, ligjin për ndalimin e diskriminimit, ligjin për barazi gjinore, që të gjitha këto me burim në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Është diskutuar edhe për rastet e diskriminimit tek personat me aftësi të kufizuara të veprimit sa i përket diskriminimit në punë.

Metodologjia e trajnimit ishte e kombinuar, ku përveç prezantimit lidhur me vështrimet profesionale dhe praktike, është aplikuar metoda interaktive e diskutimit me pjesëmarrësit. Gjithashtu, pjesëmarrësve u janë ofruar raste nga praktika gjyqësore vendore ashtu edhe nga praktika e GJEDNJ-së, të cilët i kanë paraqitur pikëpamjet e tyre në lidhje me zgjidhjen e problemeve dhe dilemave në situata të caktuara.

Këtë trajnim e vijuan 21 gjyqtarë prej tyre 3 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 2 nga Gjykata e Apelit dhe 16 të tjerë nga niveli themelor i gjykatave nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Trajnim: Legjislacioni vendor lidhur me statusin e të huajve dhe atij ndërkombëtarë



Më 19-20 tetor 2023, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar lidhur me statusin e të huajve” në kuadër të PTV-së me përkrahjen e CRPK-së/ Partner i UNHCR-së. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë për statusin e të huajve”.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan temat mbi: Legjislacionit vendor që kanë të bëjnë me statusin e të huajve; Korniza ligjore ndërkombëtare që ka të bëjë me statusin e të huajve; Pozita e të huajve dhe migrimi i parregullt; dhe praktika aktuale nacionale gjyqësore si dhe shembuj hipotetik dhe raste nga praktika gjyqësore rajonale dhe ndërkombëtare në këtë lëmi.

Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan temat mbi: Korniza ligjore ndërkombëtare që ka të bëjë me statusin e të huajve; Shqyrtimi i praktikës aktuale nacionale gjyqësore në këtë lëmi - Raste praktike; Pozita e të huajve dhe migrimi i parregullt - shembuj hipotetike dhe raste nga praktika gjyqësore rajonale dhe ndërkombëtare, dhe shqyrtimi perfundimtare lidhur me tematikën e statusit të të huajve.

Që në fillim të trajnimit u potencua se trajtimi i

kësaj teme është me rëndësi nga shkakut se në gjykata, këto çështje janë ndër çështjet e ndjeshme sikurse edhe për organet tjera shtetërore. Ndjeshmëria e tyre është ngase janë të natyrës që kanë të bëjnë me të drejta personale elementare të personave me qëndrim në një shtet të huaj, andaj si praktikë e re në gjyqësor lidhur me këto raste është e nevojshme avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe marrja e rekomandimeve lidhur me vendosjen e këtyre rasteve.

Në këtë trajnim, pjesëmarrësit u njohën në hollësi me dispozitat ligjore në fuqi dhe zbatimin e tyre në praktikë me rastin e vendosjes për të drejtat e të huajve dhe statusin e tyre në Republikën e Kosovës. U zbërthye procedura administrative që zhvillohet pranë organit administrativ, që nga parashtrimi i kërkesës për të drejtat e të huajve që garantohen me këtë Ligj, procedura pranë organit të shkallës së parë dhe ankesa në organin e shkallës së dytë, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si organ kompetent për të vendosur lidhur me kërkesat e kësaj natyre sa i përket Ligjit për të Huajt, si dhe parashtrimi i padisë dhe shqyrtimi i sajë në procedurën e konfliktit administrativ në gjykatë.

Në vazhdim u theksua se në Republikën e Kosovës, të drejtat e të huajve garantohen dhe i rregullon në mënyrë detale Ligji për të Huajt i Kosovës nr. 04/L-219 i datës 31 korrik 2019, i cili ka hyrë në fuqi më 19 gusht 2018. Ky ligj rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu pjesëmarrësit u njohën me dispozitat që përmbajnë ligjet në fuqi dhe masat që ndikojnë në parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt brenda territorit të Republikës së Kosovës e që mund të intensifikohen përmes zbatimit të dispozitave të Ligjit për të Huajt.

Në vazhdim pjesëmarrësit u njohën edhe me legjislacionin ndërkombëtarë për të drejtat e të huajve duke përfshirë Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre e vitit 1990, si dhe DIREKTIVA E KËSHILLIT 2003/109/KE e 25 nëntorit 2003 lidhur me statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë

në vendet e UE-së.

Ndër metodat kryesore që u përdoren në këtë trajnim ishin: shpjegime të pjesshme teorike; diskutime interaktive, analizë e rasteve hipotetike, raste gjyqësore nga praktika vendore dhe e shteteve të rajonit mbi parimet dhe rregullat kryesore të së drejtës ndërkombëtare dhe të brendshme, diskutime për mënyrat e nxjerrjes së vendimeve të bazuara në merita për çështjet aktuale, dhe se si gjyqtarët duhet trajtuar ankesat në shkallë të ndryshme kur vendosin në rastet konkrete.

Këtë trajnim e vijuan 4 gjyqtarë dhe 7 bashkëpunëtorë profesional si dhe 8 zyrtarë nga Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht për shtetësi, azil dhe migrim - divizioni për të huaj.



## Trajnim: Shkathtësitë e komunikimit jo-verbal

Më 20 Tetor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: Shkathtësitë e komunikimit Jo-verbal”.

Ndryshe nga trajnimet tjera ky trajnim është fokusuar në ngritjen e shkathtësive të gjyqtarëve sa i përket komunikimit jo-verbal përkatësisht për informacionin, emocionet që mund të barten tek të tjerët pa fjalë dhe pa ndihmën e gjuhës.

Trajnimi është ofruar nga një ekspert i jashtëm z. Mark Segal, avokat i cili u përqendrua në shpjegime të hollësishme sa i përket origjinës dhe rëndësisë së komunikimit jo verbal, elementet kryesore dhe me theks te rëndësia e komunikimit jo verbal për gjyqtarë.

Gjatë trajnimit u trajtuan aspekte të rëndësishme të komunikimit jo verbal i cili siq u tha është më pak i kontrollueshëm, por është më i fuqishëm sepse bart shumë emocione dhe ndjenja të cilat shpesh është e pamundur të shprehen me fjalë e nganjëherë edhe vështirë të kuptohen. Në vijim u fol për interpretimin e

gjuhës së trupit dhe potencialet që disa njerëz kanë për të kuptuar gjuhën e trupit dhe si të tillë janë më të aftë për ta kuptuar këtë gjuhë dhe janë dhe më të aftë për ta përdorur atë. Vëmendje e veçantë iu kushtua mundësive që krijon komunikimi jo-verbal, përkatësisht gjuha e trupit për të kryer misione që fjalët nuk mund të marrin përsipër gjithashtu të përkufizojnë më qartë marrëdhëniet që duan të ndërtojnë me të tjerët.

Veçanërisht u përdoren situata të komunikimit jo verbal si skuqja, dridhja apo djersitja në mënyrë të pavullnetshme.

Ky trajnim u realizua në Akademi të Drejtësisë dhe morën pjesë 9 pjesëmarrës. Prej tyre 3 gjyqtarë, 3 prokurorë si dhe 3 bashkëpunëtorë profesional të nivelit themelor të gjykatave dhe prokurorive.



## Tranim: Shtetësia dhe statusi i personave pa shtetësi-sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtarë



Më 24-25 tetor 2023, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Shtetësia dhe statusi i personave pa shtetësi-sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtarë” në kuadër të PTV-së me përkrahjen e CRPK-së/ Partner i UNHCR-së.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me shtetësinë dhe statusin e personave pa shtetësi sipas legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtarë.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan temat mbi: Konventën e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi dhe Konventës së vitit 1961 mbi Zvogëlimin e Pa-shtetësisë dhe Procedura për përcaktimin e statusit të personave pa shtetësi; E drejta e shtetësisë dhe personat pa shtetësi sipas legjislacionit vendor dhe shqyrtimi i praktikës aktuale nacionale gjyqësore si dhe shembuj hipotetik dhe raste nga praktika gjyqësore rajonale dhe ndërkombëtare lidhur me personat pa shtetësi.

Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan temat mbi: Konventa e Këshillit të Evropës mbi Shtetësinë e vitit 1997; Konventa e Këshillit të Evropës mbi Eliminimin e Pa-shtetësisë në raport me suksesimin e shteteve (2006); Shqyrtimi i praktikës aktuale nacionale gjyqësore në këtë

lëmi përmes rasteve praktike; dhe Shembuj hipotetik dhe raste nga praktika gjyqësore rajonale dhe ndërkombëtare lidhur me personat pa shtetësi.

Që në fillim u potencua se lëndët e kësaj natyre janë sfiduese për gjyqtarët meqë është praktikë e re. Andaj trajtimi i kësaj tematike ka për qëllim avancimin e njohurive të gjyqtarëve që kanë juridiksion në çështjet përkatëse dhe të marrin njohuri dhe rekomandime për të nxjerr vendime të bazuara në merita lidhur me vendosjen e këtyre rasteve.

Në këtë trajnim, pjesëmarrësit u njohën në hollësi me dispozitat ligjore në fuqi dhe zbatimin e tyre në praktikë me rastin e vendosjes për të drejtën e shtetësisë në Republikën e Kosovës. U zbërthye procedura administrative që zhvillohet pranë organit administrativ – departamenti për shtetësi, azil dhe migrim, që nga parashtrimi i kërkesës për shtetësi, Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, si organ i shkallës së dytë, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si organ kompetent për të vendosur lidhur me kërkesat e kësaj natyre, si dhe parashtrimi i padisë dhe shqyrtimi i sajë në procedurën e konfliktit administrativ në gjykatë.

Në vazhdim u theksua se Kushtetuta e Republikës së Kosovës të drejtën e shtetësisë, nuk e ka paraparë në dispozitat e saja, mirëpo ky institut gjen zbatim në mënyrë të tërthortë nëpërmes akteve ndërkombëtare që janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë përmes nenit 22 të Kushtetutës.

Gjithashtu u potencua se në Republikën e Kosovës, të drejtën e shtetësisë dhe statusin e personave pa shtetësi e rregullon në mënyrë detale Ligji për Shtetësinë i Kosovës nr. 04/L-215 i datës 31 korrik 2015. Ky ligj është në pajtueshmëri me standardet evropiane dhe ndërkombëtare dhe përmes tij përcaktohen mënyrat e fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës.

Ndër metodat kryesore që u përdoren në këtë trajnim ishin: shpjegime të pjesshme teorike;

diskutime interaktive, analizë e rasteve hipotetike, raste gjyqësore nga praktika vendore dhe e shteteve të rajonit mbi parimet dhe rregullat kryesore të së drejtës ndërkombëtare dhe të brendshme, diskutime për mënyrat e nxjerrjes së vendimeve të bazuara në merita për çështjet aktuale, dhe se si gjyqtarët duhet trajtuar ankesat në shkallë të ndryshme kur vendosin në rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin 5 gjyqtarë nga departamenti administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe nga departamenti i përgjithshëm i gjykatave tjera duke përfshirë dhe 1 bashkëpunëtorë profesional dhe 1 zyrtarë ligjor.

## Trajnim: Aftesite e Prokurorit për Paraqitjen e Çështjes në Gjyq

Më 25 tetor 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë, në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta për prokurorët e dy vendeve realizuan në Tiranë trajnimin me temë: “Aftësitë e Prokurorëve për Paraqitjen e Çështjes në Gjyq”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira të dy vendeve sa i përket përfaqësimit të çështjes në gjykatë nga ana e prokurorit.

Në hapjen e këtij trajnimi ishte prezent Drejtori i Shkolles së Magjistratures, z. Arben Rakipi dhe znj. Luljete Hetemi, Udheheqese e PHP-se ne Akademinë e Drejtësisë. Nga të dy institucionet u konfirmua përkushtimi i mëtejme për aktivitetet tjera të radhës të cilat do të përafrojnë edhe më tej njohjen e ndërsjellë, komunikimet dhe ndarjen e praktikave më të mira në funksion të bërjes më të mirë të drejtësisë.

Trajnimi në fillim u përqendrua në perspektiven e jurisprudencës së Shqipërisë sa i përket hetimit dhe gjyqimit dhe specifikat e paraqitjes së çështjeve në gjykatë e cila u

elaborua në mënyrë të hollësishme nga Drejtori i Drejtorisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme të Shqipërisë z. Arqilea Koça e pastaj edhe nga perspektiva Kosovare U.D i Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës z. Besim Kelmendi.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe rasteve kur paraqitja e çështjes në gjykatë do të realizohet nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe përgatitjet që duhet pasur në konsideratë prokurorët në rastet e tilla. Për këto situata u ofruan përparësitë dhe dobësitë eventuale si dhe përvojat praktike nga të dy sistemet juridike.

Prokurorët nga dy vendet patën rastin e diskutimit për shumë çështje ligjore si për urdhrat hetimor, aktin e delegimit të hetimit te policia, për planet e hetimit dhe veprime tjera hetimore për të cilat u ofruan praktikat më të mira dhe njëherësh zgjidhjet më të mire ligjore që janë fushë veprimi i tyre.

Këtë trajnim e vijuan 11 prokurorë nga Kosova nga të gjitha instancat dhe regionet e Kosovës si dhe 12 prokurorë nga Shqipëria.



## Trajnim: Përmirësimi i efikasitetit të gjykatave në bazë të Instrumenteve dhe indikatorëve të CEPEJ-it për performancë duke i përdorur raportet statistikore të SMIL dhe tabelat

Më 26 tetor 2023, në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, projekti i KOSEJ III është realizuar trajnimi dy ditorë me fokus te metodologjia e CEPEJ në ngritjen e efikasitetit të Gjykatave dhe zyrave të Prokurorive në bazë të raporteve statistikore dhe dashbordeve në SMIL.

Ky trajnim ishte vazhdimësi e trajnimit të nivelit të parë mbi metodologjinë e CEPEJ, i zhvilluar gjatë vitit 2022, me ç'rast objektivi i përgjithshëm i trajnimit ishte përmirësimi i njohurive për mjetet e CEPEJ-it dhe mundësitë e ofruara nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve (SMIL) për të përmirësuar funksionimin e gjykatave, me fokus në performancën e gjykatës dhe kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore.

Trajnimi është fokusuar kryesisht në mbështetjen e vendimeve të bazuara në të dhëna, duke përdorur metodologjinë dhe treguesit e CEPEJ-it. Programi i trajnimit ishte i dizajnuar marrë parasysh nivelin e mundshëm të njohurive të ndryshme të mjeteve të CEPEJ-it të prokurorive në krahasim me gjykatat.

Trajnimi ofroi një mundësi për Gjykatat/ Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Prokuroritë/

Këshillin Prokurorial të Kosovës që të diskutojnë sfidat e përbashkëta në lidhje me efikasitetin dhe performancën dhe të identifikojnë zgjidhjet e mundshme bazuar në metodologjinë CEPEJ.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit janë ndarë edhe në grupe punuese dhe kanë paraqitur arritjet, sfidat, problemet lidhur me pranimin e lëndëve, procedimin e tyre, monitorimin e punës përmes SMIL.

Trajnimi është mbështetur dhe moderuar nga katër eksperët e angazhuar nga Këshilli i Evropës: z. Ivan CRNČEC, Eksperti i CEPEJ/ Zëvendëskryetar i CEPEJ (Kroaci); z. Vincent MACQ, Ekspert i CEPEJ/Kryeprokuror (Belgjikë); z. Rimantas SIMAITIS, Eksperti i CEPEJ për ndërmjetësim dhe për drejtësinë kibernetike (Lituani); znj. Ana KRNIC, Ekspert i CEPEJ për peshimin e lëndës (Kroaci).

Përfitues të trajnimit ishin Kryetarët e Gjykatave, Kryeprokurorët, zyrtarët e Departamenteve të IT dhe statistikave në Gjykata dhe Prokurori.



## Trajnim: Ndërmjetësimi-regjioni (Ferizaj-Gjilan)

Më 26 tetor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me Programin e “USAID – Drejtësia Komerciale”, është realizuar trajnimi me temë “Ndërmjetësimi” për regjionin e Ferizajt dhe Gjilanit.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe ndërmjetësuesve lidhur me metodën alternative për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet dy apo më shumë personave dhe zbatimin e drejtë të ndërmjetësimit dhe procedurës në praktikë.

Trajnimi ka filluar direkt me shtjellimin nga ana e trajnuesit për gjendjen aktuale të ndërmjetësimit dhe shkaktarët që e kanë sjellë në këtë gjendje ku janë renditur në tri grupe: keqkuptimi, keqinterpretimi dhe keqpërdorimi, duke vazhduar me dhënien e sqarimeve për secilin grup.

Në trajnim fokus i veçantë ka qenë roli i gjyqtarit dhe ndërmjetësuesit në procedurën e ndërmjetësimit, pasi që në praktikë nuk është duke u vepruar konform rolit dhe përgjegjësisë nga këta dy akterë kryesor.

Po ashtu është diskutua edhe referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore. Vëmendje të veçantë iu kushtua zbatimit të procedurës tek ndërmjetësimi i detyrueshëm, ekzaminimit të marrëveshjes së ndërmjetësimit dhe hapat që pasojnë duke përfshirë edhe debat profesional, shoqëruar me praktike, dhe me udhëzime të qarta dhe bindëse pothuajse për secilin problem, sfidë apo dilemë të ngritur.

Ky trajnim shërbeu si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Këtë trajnim e vijuan 21 gjyqtarë, 1 bashkëpunëtorë profesional dhe 1 administrator si dhe 6 ndërmjetësues dhe 1 avokat nga këto dy regjione.



## Tryezë: Viktimat e dhunës seksuale

Më 26 Tetor 2023, në bashkëpunim me GIZ në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimin me temë “Viktimat e Dhunës Seksuale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë ligjor në zbatimin e drejtë të legjislacionit në fuqi në rastet e dhunës seksuale për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve përkatëse.

Gjatë këtij trajnimi u diskutua për dhunën seksuale, format e dhunës seksuale dhe në përgjithësi për veprat penale kundër integritetit seksual dhe konceptet e ligjit vendor dhe ndërkombëtarë sa i përket këtyre veprave. Vëmendje e veçantë i është kushtuar Legjislacionit procedural penal për viktimat e dhunës seksuale me theks te profili i të mbijetuarve të dhunës seksuale, intervistimi

dhe shmangia nga ri traumatizmi si dhe për veprimet që duhet të merre policia dhe prokuroria në rastet e të mbijetuarve të dhunës seksuale.

Në kuadër të këtij trajnimi janë trajtuar edhe mbrojtja, mbështetja dhe ndihma që duhet ofruar të mbijetuarve të dhunës seksuale, ndërgjegjësimi për njohjen e nevojës për referim si dhe aspekte tjera të rëndësishme si trauma sekondare dhe vet kujdesi.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Këtë trajnim e vijuan 14 gjyqtarë, 2 prokurorë si dhe 10 zyrtarë të Ndhmës Juridike Falas



## Trajnim: Krimet e urrejtjes

Më 31 Tetor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimin me temë “Krimet e urrejtjes”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive themelore lidhur me konceptin e krimeve të urrejtjes, për zbatimin e drejtë të legjislacionit në fuqi në rastet gjyqësore.

Trajnimi në fillim u përqendrua në shpjegime të hollësishme sa i përket kuptimit të krimeve të urrejtjes ndërkaq në vijim trajtoi kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare me theks te identifikimi dhe hetimi i krimeve të urrejtjes, veçantitë e krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes duke përfshirë edhe aktet ndërkombëtare lidhur me luftimin dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes si dhe sanksionimi sipas ligjit vendor dhe disa vendeve evropiane i gjuhës së urrejtjes.

Po ashtu është diskutuar edhe për motivin e paragjykitimit ku mund të jetë i përfshirë në veprën penale bazë, së bashku edhe me elementet tjera të veprës penale, e që përbën vepër penale bazë. Për shembull te vepra penale Vrasje e rëndë “vrasja e motivuar në bazë të kombësisë” përbën vepër penale bazë që përfshin edhe motivin e paragjykitimit.

Ky trajnim shërbeu si orientim edhe për paragjykimet kundër gjinisë ku mund të përfshij një spektër të gjerë të incidenteve kundër grave dhe burrave. Për shembull, shumë nga rastet e quajtura “dhunë kundër grave”, të ashtuquajturat “vrasje nga nderi” (honor killings) dhe krimet seksuale, ngjashëm edhe veprat penale të kryera kundër organizatave feministë janë lloje të krimeve të urrejtjes. Edhe pse shumë nga krimet e kryera kundër grave përmbajnë elementin e paragjykitimit, është e rëndësishme që reagimet ndaj këtyre krimeve të përfshijnë një qasje tjetër të veçantë, që do të përmbushnin më së miri nevojat e viktimave të atyre krimeve.

Trajnimi është zhvilluar me debat profesional, shoqëruar me praktike, dhe me udhëzime të qarta dhe bindëse pothuajse për secilin problem, sfidë apo dilemë të ngritur apo të identifikuar qoftë nga trajnuesi gjatë hulumtimit dhe si rezultat i trajnimeve të mëhershme qoftë nga pjesëmarrësit.

Këtë trajnim e vijuan 5 gjyqtarë, 1 prokurorë si dhe 5 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive, kryesisht të nivelit themelor.





## Aktivitetet trajnuese për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive

### Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal material dhe procedural- Grupi V



Më 03-05 tetor 2023, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar sesionet e trajnimit për bashkëpunëtorë profesional. Kësaj radhe për grupin e V -të nga Moduli Bazik për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor me temë “Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale”.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimin e drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritore të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga pjesa e përgjithshme e së drejtës penale u diskutua për parimet e përgjithshme në zbatimin e Ligjit më të favorshëm me fokus te vlerësimet lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm, Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si dhe Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se.

Në kuadër të këtyre trajnimeve u diskutua për shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë me theks te mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, vepra e rëndësishme

së vogël dhe përgjegjësia penale. Në kuadër të pjesës së posaçme është diskutuar për veprat penale kundër jetës dhe trupit me theks te vrasja dhe vrasja e rëndë si dhe për veprat penale kundër integritetit seksual duke trajtuar me vëmendje të veçantë aspekte të rëndësishme të dhunimit dhe sulmit seksual.

Në veçanti u trajtuan Politikat ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, konflikti i interesit, përvetësimi dhe mashtrimi ne detyre, marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtar. Gjithashtu u elaboruan rrethanat renduese dhe rrethanat lehtësuese për matjen e dënimit, ndalimi i dyfishimit te rrethanave për matjen e dënimit si dhe faktorët specifik te rrethanave për ta peshuar me rastin e matjes se dënimit.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të shumta studimore të bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe ndihmës në kryerjen e veprave penale të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

03 tetor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 30 pjesëmarrës, prej tyre ishin 13 bashkëpunëtorë profesional, 15 zyrtar ligjor, 1 referent dhe 1 sekretar juridik.

04 tetor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 29 pjesëmarrës, prej tyre 13 bashkëpunëtorë profesional, 14 zyrtar ligjor, 1 referent 1 sekretar juridik.

05 tetor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 28 pjesëmarrës prej tyre 13 bashkëpunëtorë profesional, 14 zyrtar ligjor dhe 1 referent.

## Trajnimi për përkthyes dhe interpretë gjyqësor mbi përdorimin e koncepteve ligjore dhe doracakun për punën e përkthyesve në gjykata

Me 05-6 tetor 2023, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nën mbështetjen e projektit EUKOJUST është realizuar trajnimi për Interpretët Gjyqësorë të të gjitha gjykatave të Republikës së Kosovës.

Ky trajnim vjen si rezultat i zhvillimit të doracakut për punën e përkthyesve në Gjykata dhe ka për qëllim që gjithë interpretët që janë pjesë e gjykatave si dhe ata të sapo rekrutuarit të njihen me doracakun dhe përmbajtjen e tij i cili ka 8 pika kyçe si:

- Procedura e angazhimit të përkthyesit/interpretit;
- Detyrat dhe përgjegjësitë e përkthyesit;
- Kodi i Etikës;
- Norma orientuese e përkthyesit/interpretit;
- Mbajtja e evidencës dhe raportimi;
- Paanshmëria dhe konflikti i interesit;
- Pozicioni i përkthyesit në sallën e gjykimit;
- Performanca e përkthyesit/interpretit.

Meqenëse pjesë e trajnimit ishin një grup goxha i madh i përfituesve, trajnimi është ndarë në dy grupe, ku për dy ditë, përkthyesit patën

rastin të dëgjojnë dhe diskutojnë rreth përkthimit të terminologjive juridike, sfidat gjatë përkthimit dhe interpretimit sidomos për konceptet e reja juridike dhe unifikimit të terminologjisë mes përkthyesve si dhe pjesët e doracakut veç e veç.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën rastin të dëgjojnë edhe video sekuenca të shkurtra nga seancat gjyqësore në veçanti nga Tribunali i Hagës, pastaj simulime të gjykimeve dhe seancave gjyqësore, të përgatitura nga dy ekspertet e angazhuara për këtë trajnim znj. Filloreta Hoxha – eksperte për menaxhimin e shërbimeve të përkthimit dhe znj. Valentina Sopjani – Shefe e zyrës së përkthimeve në SKGJK.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 48 përkthyes, interpreto nga të gjitha gjykatat e Republikën e Kosovës. Në ditën e parë morën pjesë 22 përkthyes, ndërkaq në ditën e dytë 26 përkthyes dhe interpreto të tjerë.



## Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal material dhe procedural Grupi V-të

Më 09-11 Tetor 2023, për grupin e V-të të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor janë vazhduar 3 sesionet e radhës nga Moduli bazik në fushën penale. Këto sesione ishin për aspektin procedural me theks te “Fazat e procedurës penale, Mjetet Juridike dhe procedurat e veçanta si dhe Aktakuza - shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi”.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive për procedurën penale dhe zbatimin e saj drejtë në praktikën gjyqësore.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese u diskutua për parimet, kompetencën dhe palët në procedurën penale, Veprimet parapenale dhe fazat e procedurës penale, Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit në procedurën penale, Fazat e procedurës penale, Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi.

Gjatë këtyre trajnimeve u trajtuan: Kallëzimi penal, procedura paraprake, Aktvendimi për hushje të kallëzimit penal, aktvendimi për fillimin e hetimeve, Aktvendimi për zgjerimi të

hetimeve si dhe Aktvendimi për pushim të hetimeve. Në vazhdim u trajtuan Mjetet juridike, administrimi i procedurës, procedura për dhënien e urdhërit ndëshkues si procedurë e veçantë si dhe procedura e shlyerjes së dënimeve nga evidenca. Në veçanti u trajtua Shqyrtimi gjyqësor dhe aktgjykimi.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve nga praktika gjyqësore, përmes pune s ne grupe te hartojnë vendimet gjyqësore, të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zërthejnë dispozitat ligjore.

09 tetor 2023, Përfitues në trajnim ishin 26 pjesëmarrës, prej tyre 12 ishin bashkëpunëtorë profesional, 13 zyrtar ligjor 1 referent i lartë.

10 tetor 2023, Përfitues në trajnim ishin 28 pjesëmarrës, prej tyre 12 bashkëpunëtorë profesional, 15 zyrtar ligjor dhe 1 referent i lartë.

11 tetor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 27 pjesëmarrës prej tyre 10 bashkëpunëtorë profesional, 16 zyrtar ligjor dhe 1 referent i lartë.



## Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal material dhe procedural Grupi VI-të



Më 16-17 tetor 2023, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar sesionet e trajnimit për bashkëpunëtorë profesional. Kësaj radhe për grupin e VI -të nga Moduli Bazik për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor me temë “Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale”.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimi i drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritore të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga pjesa e përgjithshme e së drejtës penale u diskutua për parimet e përgjithshme në zbatimin e Ligjit më të favorshëm me fokus te vlerësimet lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm, Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si dhe Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se.

Në kuadër të këtyre trajnimeve u diskutua për shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë me theks te mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, vepra e rëndësisë së vogël dhe përgjegjësia penale. Në kuadër të

pjesës së posaçme është diskutuar për veprat penale kundër jetës dhe trupit me theks te vrasja dhe vrasja e rëndë si dhe për veprat penale kundër integritetit seksual duke trajtuar me vëmendje të veçantë aspekte të rëndësishme të dhunimit dhe sulmit seksual.

Në veçanti u trajtuan Politikat ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, konflikti i interesit, përvetësimi dhe mashtrimi ne detyre, marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtar. Gjithashtu u elaboruan rrethanat renduese dhe rrethanat lehtësuese për matjen e dënimit, ndalimi i dyfishimit te rrethanave për matjen e dënimit si dhe faktorët specifik te rrethanave për ta peshuar me rastin e matjes se dënimit.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të shumta studimore të bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe ndihmës në kryerjen e veprave penale të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

16 tetor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 28 pjesëmarrës, prej tyre ishin 09 bashkëpunëtorë profesional, 17 zyrtar ligjor, 1 referent.

17 tetor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 30 pjesëmarrës, prej tyre 9 bashkëpunëtorë profesional, 18 zyrtar ligjor, 1 referent dhe 2 sekretar juridik.

18 tetor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 28 pjesëmarrës prej tyre 7 bashkëpunëtorë profesional, 18 zyrtar ligjor dhe 1 referent dhe 2 sekretar juridik.

## Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal material dhe procedural Grupi VI-të

Më 23-25 Tetor 2023, për grupin e VI-të të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor janë vazhduar 3 sesionet e radhës nga Moduli bazik në fushën penale. Këto sesione ishin për aspektin procedural me theks te “Fazat e procedurës penale, Mjetet Juridike dhe procedurat e veçanta si dhe Aktakuza - shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi”.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive për procedurën penale dhe zbatimin e saj drejtë në praktikën gjyqësore.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese u diskutua për parimet, kompetencën dhe palët në procedurën penale, Veprimet parapenale dhe fazat e procedurës penale, Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit në procedurën penale, Fazat e procedurës penale, Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi.

Gjatë këtyre trajnimeve u trajtuan: Kallëzimi penal, procedura paraprake, Aktvendimi për hudhje të kallëzimit penal, aktvendimi për fillimin e hetimeve, Aktvendimi për zgjerimi të hetimeve si dhe Aktvendimi për pushim të hetimeve. Në vazhdim u trajtuan Mjetet

juridike, administrimi i procedurës, procedura për dhënien e urdhërit ndëshkues si procedurë e veçantë si dhe procedura e shlyerjes së dënimeve nga evidenca. Në veçanti u trajtua Shqyrtimi gjyqësor dhe aktgjykimi.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve nga praktika gjyqësore, përmes punës në grupe të hartojnë vendimet gjyqësore, të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

23 tetor 2023, Përfitues në trajnim ishin 26 pjesëmarrës, prej tyre 8 ishin bashkëpunëtorë profesional, 16 zyrtar ligjor, 1 referent i lartë dhe 1 sekretar juridik.

24 tetor 2023, Përfitues në trajnim ishin 25 pjesëmarrës, prej tyre 6 bashkëpunëtorë profesional, 17 zyrtar ligjor, 1 referent i lartë dhe 1 sekretar juridik.

25 tetor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 29 pjesëmarrës prej tyre 9 bashkëpunëtorë profesional, 17 zyrtar ligjor, 1 sekretar juridik.



## Trajnim: Menaxhimi i kohës dhe stresit

---



Me 31 tetor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme për stafin administrativ të gjykatave është realizuar trajnimi me temë: “Menaxhimi i Stresit”.

Qëllimi i trajnimit ishte që stafi administrativ i Gjykatave dhe Prokurorive të fitojnë njohuri bazike rreth formave të manifestimit të stresit dhe menaxhimin e tij për të kontrolluar dhe shmang impaktin negativ në procesin e punës.



Trajnimi u përqendrua në shpjegime të hollësishme sa i përket përkufizimit të stresit dhe në vijim për llojet e stresit, mënyrat e përballjes me stresin dhe tejkalimit të tij,

shenjat fillestare të stresit, etj.


Gjithashtu në mënyrë interaktive mes trajnuesit dhe pjesëmarrësve u diskutuan edhe pasojat e stresit në punë, pasojat e stresit në shëndet, si dhe strategjitë më të mira të administrimit të kohës në mënyrë sa më efektive.

Këtë trajnim e vijuan 16 zyrtarë administrativ të gjykatave dhe prokurorive nga të gjitha regjionet e Kosovës. Prej tyre 6 nga gjykatat dhe 10 nga prokuroritë e nivelit themelor.

## Vijueshmëria në trajnime në PTF e shfaqur përmes grafikoneve




## Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve






## Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve




Numri i pjesëmarrjes dhe trajnimeve të realizuara sipas fushës-Tetor 2023



Numri i pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara -Tetor 2023



## Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

[infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel: +383 38 200 18 660